



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"  
SENATI

Nr. 4192 prot.

Shkodër, më 22.12.2023

V E N D I M

Nr. 298, datë 22 . 12 .2023

**"Për miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë mësimore-shkencore dhe  
financiare të USH-së për vitin akademik 2022-2023"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 32, 38; Statutit të USH-së neni 17, pika 6, germa II, Udhëzim nr.5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të IAL-ve", i ndryshuar, Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, në mbledhjen e përbashkët të datës 22.12.2023

**Vendosi:**

1. Të miratojë raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-shkencore dhe administrative për vitin akademik 2022-2023 në Universitetin e Shkodrës, "Luigj Gurakuqi"(materjali bashkëngjitur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE E SENATIT  
AKADEMIK**

Prof. Dr. **Rajmonda KËCIRA**



**KRYETAR I BORDIT  
TË ADMINISTRIMIT**

**Adrian LEKA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"



Nr. 4194 Prot

Shkodër, më 22.12. 2023

**RAPORTI VJETOR I VEPRIMTARISË MËSIMORE DHE SHKENCORE PËR VITIN  
AKADEMIK 2022-2023 NË UNIVERSITETIN E SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**



**Përmbajtja**

**A.SENATI AKADEMIK .....**

Tabela nr. 1: Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies.....5

Tabela nr. 2: Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit .....27

Tabela nr. 3: Mbi bashkëpunimin ndërinstitucional .....45

Tabela nr. 4: Mbi Projekte e kërkimit shkencor në të cilat IAL ka aplikuar për financim .....46

Tabela nr. 5: Mbi Aktivitet e kërkimit shkencor të realizuara .....51

Tabela nr. 6: Mbi Infrastrukturën e kërkimit shkencor .....71

Tabela nr. 7: Mbi programet e studimit.....73

Tabela nr. 8: Mbi veprimtarinë e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë .....90

Tabela nr. 9: Për angazhimin e personelit akademik .....91

Tabela nr. 10: Për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet.....102

Tabela nr. 11: Mbi përbërjen e Këshillave Studentorë.....105

Tabela nr. 12: Mbi studentët që kanë qënë anëtarë dhe përfaqësues në organet e IAL-së.....106

Tabela nr. 13: Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve.....107

Tabela nr. 14: Mbi numrin e studentëve të çrregjistruar dhe transferuar.....118

Tabela nr. 15: Mbi numri i studentëve të ciklit të parë që përfitojnë bursë sipas VKM nr.903, datë 21.12.2016 (përditësuar) të ndara sipas kriterëve .....118

Tabela nr. 16: Mbi numrin e studentëve të ciklit të parë që paguajnë tarifë ( 50% ose 100%) sipas VKM nr. 288, datë 21.05.2018 (përditësuar) të ndarë sipas kriterëve.....118

Tabela nr. 17: Mbi numrin e studentëve të ciklit të parë që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, sipas VKM nr. 269, datë 29.03.2017 (përditësuar) të ndarë sipas kriterëve .....118

Tabela nr. 18: Mbi numrin e studentëve të ciklit të dytë që paguajnë tarifë (50 %) të ndarë sipas kriterëve të VKM nr. 780, datë 26.12.2018 .....118

Tabela nr. 19: Mbi pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre .....128



**B.BORDI ADMINISTRIMIT**

Tabela nr. 20: Mbi numrin e personelit të IAL-së .....	132
Tabela nr. 21: Për planin buxhetor afatmesëm .....	
Tabela nr. 22: Për planin buxhetor njëvjeçar .....	
Tabela nr. 23: Për realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor .....	
Tabela nr. 24: Për realizimin faktik të buxhetit nga Granti i Mësimdhënies për vitin paraardhës buxhetor (programi buxhetor 09450, kapitulli 08, artikulli 600–606) .....	
Tabela nr. 25: Për realizimin faktik të buxhetit nga Granti i Punës Kërkimore-Shkencore dhe i Veprimtarive Krijuese për vitin paraardhës buxhetor (programi buxhetor 09770, kapitullin 01, artikulli 604 .....	
Tabela nr. 26: Për realizimin faktik të buxhetit nga Grantit i Politikave të Zhvillimit për vitin paraardhës buxhetor (programi buxhetor 09450, kapitullin 01, artikulli 230-231).....	
Tabela nr. 27: Për planin buxhetor të vitit pasardhës akademik.....	
Tabela nr. 28: Për tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim .....	
Tabela nr. 29: Mbi mobilitetin e personelit akademik.....	134
Tabela nr. 30: Për plotësimin e standardeve shtetërore infrastrukturore .....	

Raporti mbi veprimtarinë vjetore mësimore dhe shkencore është hartuar duke u bazuar në udhëzuesin “Për modelin e raportimit vjetor të Institucioneve Publike të Arsimit të lartë, në zbatim të udhëzimit Nr. 5, dt. 19.2.2018, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit”, datë 31.07.2023 dhe ka për qëllim të paraqesë veprimtarinë mësimore dhe shkencore të realizuar nga të gjitha strukturat e Universitetit “Luigj Gurakuqi”.

## A. SENATI AKADEMIK

**a. Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor.**

### i. Fusha Mësimdhënia

#### Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies

**Strategjia e mësimdhënies** në Universitetin e Shkodrës bazohet në **planin Strategjik** të këtij universiteti, i cili në përputhje me qëllimin e arsimit të lartë në Shqipëri, synon të ofrojë arsim të lartë gjithëpërfshirës, transparent, me integritetit ekonomik, që plotëson standardet kombëtare të cilësisë dhe promovon zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit.

Objektivat e të gjitha programeve të studimit janë në harmoni me Strategjinë e mësimdhënies në USH ku citohet: *“Misioni i Universitetit të Shkodrës është krijimi, zhvillimi, mbrojtja dhe transmetimi i dijeve me anën e mësimdhënies mbështetur në Deklaratën e Bolonjës dhe punës kërkimore-shkencore, formimi i specialistëve të lartë dhe përgatitja e shkencëtarëve të rinj”*.

Procesi i mësimdhënies në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” gjatë vitit akademik 2022-2023 ka synuar:

- Arritjen e standarteve të larta në mësimdhënie;
- Të rrisë cilësinë nëpërmjet riorganizimit të programeve të studimit, modernizimit të infrastrukturës akademike dhe aplikimit të standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit;
- Të krijojë një mjedis mbështetës në partneritet me studentët ku ata të ndihen përgjegjës, vetë-efikasë dhe të pavarur në procesin e të nxënies;
- T'u ofrojë studentëve mundësinë për të zhvilluar aftësitë e tyre gjuhësore, kulturore dhe profesionale që të përfitojnë nga universitetet me fokus global nëpërmjet programeve të shkëmbimit të studentëve ose marrëveshjeve me partnerë në disiplina të veçanta;
- T'u sigurojë studentëve mundësi për një angazhim profesional në një shumëllojshmëri kontekstesh në përputhje me programin e studimit (vëzhgime, praktika në shkolla, ndërmarrje, biznese, klinika ligjore, klinika mjekësore, ekspedita);
- Të zbatojë standarde të larta të vlerësimit të brendshëm institucional dhe të programeve të studimit me qëllim që ato të akreditohen me kohëzgjatjen maksimale.

#### **Tabela nr. 1: Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies**

**Objektivi I: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e mësimdhënies**

Nr	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Fakulteti/ Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE TE EDUKIMIT</b>						
1	Formimi i studentëve me njohuritë të përgjithshme bazë në fushën e psikologjisë, punës sociale, mësuesisë, arsim parashkollor dhe arsim fillor, edukimi fizik e sporte dhe arte dhe njohurive të thelluara përtë formuar specialistë të lartë të aftë dhe konkurues në tregun e punës.	përditësim i leksioneve, përdorim i literaturës bashkëkohore, zhvillimi i semeninareve ne menyre nderaktive me studentet, ilustrimi me materiale shitesë, zhvillimi I detyrave të kursit, përfshirja e studentëve në veprimtari të hapura, nxitja e kërkimit shkencor, përdorimi i teknologjisë në funksion të mësidhënies.	FSH E	Po	20 22 - 20 23	
2	Forcimi i cilësisë së mësimdhënies.	Marrja e fidbekut nga studentet, diskutimi i rezultateve të përfuara, diskutim i punës mësimore e shkencore, planifikimi i objektivave për vitin pasardhës, diskutimi i syllabuseve dhe miratim i tyre në nivel deparatament në fillim të vitit akademik, shqyrtim i çdo ankesa të bërë nga studentët, etj.	FSH E	Po	20 22 - 20 23	
3	Akreditimi i programeve të studimit.	Përgatitja e dokumentacionit dhe përfshirë në proces akreditimi për katër programe studimi të nivelit Bachelor (BA në Mësuesi për Arsim Fillor, BA në	FSH E	Po	20 22 - 20 23	Planifikojmë përfshirjen në proces akreditimi edhe I tre programe të tjera Bachelor,

(BA Punë Sociale, BA në Pikurë e Grafikë, BA në Pedagogji Muzikore)



	Mësuesi për Arsim Parashkollor, BA në Psikologji dhe BA në Edukim Fizik e Sporte)				
4	hapja e programeve të reja të studimit.	janë hapur dy programe studimi të ciklit të II, pranë departamentit të Arteve, MP Mësues muzike dhe Mësues i Artit Pamor, pranë departamentit të Mësuesisë, (Master Profesional në "Pedagogji Speciale" dhe Formimi i Vazhduar Psiko-Pedagogjik).	FSH E	PO	20 22 - 20 23 dh e 20 23 - 20 24
5	ngritja e mëtjshme e nivelit shkencor e profesional të stafit akademik, kualifikimi i mëtjshëm i tyre,	Fitimi I titulli Prof. as në fushen e mëtjshisë (një anëtare) dhe marrja e gradës shkencore në fushën e psikologjisë (një anëtare).	FSH E (Dep artam enti I Mësu esisë)	Po	20 22 - 20 23

**FAKULTETI I GJUHEVE TE HUAJA**

**I Për nivelin Bachelor:**

1.	Formimi i studentëve me njohuritë e përgjithshme bazë në fushën e gjuhësisë e letërsisë italiane/frënge/gjermane/angleze, kulturës dhe qytetërimit të Italisë dhe vendeve frëngjishtfolëse, ghermanishtfolëse dhe anglofone	përditësim i leksioneve, përdorim i literaturës bashkëkohore, shtjellim i materialeve teorike, trajtim shkencor i materialeve diskutim i ecurisë didaktike bashkëpunim student/pedagog përfshirje në mënyrë interaktive në orët teorike të menduarit dhe të zhvilluarit e ideve	FGJH	100%	20 22 - 20 23
2.	Aftësimi i studentëve në fushën e	përdorim të teknikave bashkëkohore	FGJH	100%	20 22



	përkthimit e të komunikimit ndërkulturor.	përkthim simultan dhe konsektiv			- 20 23	
<b>I</b>	<b>Për nivelin Master:</b>					
	1. Formimi profesional të studentëve në mësimdhënies e gjuhës italiane, frënge, gjermane dhe angleze.	diskutim i ecurisë didaktike bashkëpunim student/pedagog përfshirje në mënyrë interaktive në orët teorike	FGJH	100%	20 22 - 20 23	
	2. Formimi i aftësive krijuese dhe garantimin e cilësisë në mësimdhënie.	të menduarit dhe të zhvilluarit e ideve	FGJH	100%	20 22 - 20 23	
	3. Të pajisë studentët me njohuri bashkëkohore rreth mësimdhënies së gjuhës angleze, italiane, gjermane, frënge. Këto njohuri përfshijnë një rang të gjerë aspektesh si: psikologji zhvillimore, teoritë e nxënies dhe të vlerësimit, menaxhim e planifikim të mësimdhënies, didaktikë të gjuhës e kulturës gjuhëve të huaja, etj.	Diskutime, punë në grup në lidhje me punën e mësuesit. Aktivizimi i studentëve edhe në orët e leksioneve. Projekte mbi aspekte të caktuara të mësimdhënies dhe psikologjisë zhvillimore.	FGJH	100%	20 22 - 20 23	
<b>FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE</b>						
<b>1</b>	Sigurimi i një mjedisi mësimor tërheqës profesional dhe social për të gjitha nivelet	Përfshirja e studentëve në projekte/trainime/kërkime ku vetë pedagogët janë udhëheqës shkencor	Departamenti i Gjeografisë	Konferencë studentore "Gjeografia sot"	20 22 - 20 23	
<b>2</b>	Sigurimi i mësimdhënies të bazuar në kërkim shkencor sidomos për programet e ciklit të dytë	22-25 mars, në kuadër të projektit "Katastrofat nuk njohin kufinj 2", studentet e Masterit Shkencor të Gjeografisë ishin pjesë e				




	<p>trajnimin ndërkufitar “Parashikimet e motit dhe sistemet e hershme të paralajmërimit”, në qytetin e Podgoricës, Mal i Zi. - Me 11-13 tetor 2023, studentet e Masterit Shkencor të Gjeografisë ishin pjesë e trajnimit, “Parashikimet e motit dhe sistemet e hershme të paralajmërimit”, në qytetin e Shkodrës, i organizuar nga Prefektura e Shkodrës në bashkëpunim me Forseth Montenegro, një projekt i financuar nga BE</p>			
<p>Sigurimi i arsimit të përshtatshëm për tregun e punës dhe që ofron rritjen e kapaciteteve në fushën e zgjidhjes së problemeve</p>	<p>Diversifikimi i kurrikulës me lëndë të reja, jashtë profilit të gjeografisë, por të domosdoshme për plotësimin e portofolit të njohurive sikurse “Menaxhim dhe shkrim projektesh”, “Shprehi dhe teknika komunikimi” - 5-7 janar 2023 ekspeditë mësimore në terren, pjesa juglindore e Shqipërisë me studentët e masterit Shkencor Gjeografi. Kjo ekspeditë kishte për qëllim njohjen më të mirë të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të kësaj zone, si dhe plotësimin e disa pyetësorëve në lidhje me gjendjen social-ekonomike të zonës dhe proceset e zhvillimit të agroturizmit. 9 qershor 2023 studentët e Gjeografisë ishin pjesë e trajnimit "Menaxhimi i mbetjeve dhe i burimeve ujore". Përgjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit u</p>	<p>Departamenti i Gjeografisë</p>	<p>20 22 - 20 23</p>	

3



	njohën me kuadrin ligjor dhe rregullator në sektorin e menaxhimit të mbetjeve dhe burimeve ujore, institucionet përgjegjëse, dokumentet strategjike, problematikat, nevojat, planifikimin, rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm në nivel lokal, kombëtar e rajonal mbi menaxhimin e mbetjeve dhe ujit.				
4	Diversifikimi i metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit që inkurajojnë rezultatet e të nxëniet dhe i përshtaten shkallëve të ndryshme të njohurive	Përfshirja në programet (syllabuset) e lëndëve e vlerësimit nëpërmjet realizimit të detyrave të kursit në trajtën e projekteve të vogla kërkimore shkencore.	Departamenti i Gjeografisë		20 22 - 20 23
5	Hapja e programeve (Bachelor ose Master) që targetojnë segmente specifike të tregut të punës	nuk ka patur	Departamenti i Gjeografisë		
6	Ruajtja dhe zhvillimi i lëndëve tradicionale që ofrohen nga programet si elementë të rëndësishëm të formimit bazik në disiplinë.	Ruajtja e ngarkesës së lëndëve tradicionale të gjeografisë fizike dhe humane si lëndë bazë tradicionale të programeve të të gjitha cikleve	Departamenti i Gjeografisë		20 22 - 20 23
7	Hartimi i leksioneve te reja per programnin e ri te studimit Bachelor ne "Histori dhe trashëgimi kulturore"	Takime ne departament per diskutim rreth leksioneve te reja	Departamenti i Historisë	Realizuar	20 22 - 20 23
8	Rishikimi i leksioneve ekzistuese per programet e studimit qe mbulon departamenti	Takime ne departament per diskutim rreth leksioneve te reja per perditësimin e literatures qe i jepet per studim studenteve	Departamenti i Historisë	Realizuar	20 22 - 20 23 Mangesi ne Biblioteken e USH me tituj te rinj
9	Digjitalizimi i procesit mesimor	Realizimi i temave nepermjet teknologjise	Departamenti i Historisë	Realizuar	20 22 - 20 Mangesi ne teknike dixhitale



			rise		23	
10	Futja e metodave te reja ne procesin e mesimdhenies	Takime ne grup lendesh	Departamenti i Historise	Realizuar	20 22 - 20 23	Mos përfshirja e stafit te departamentit ne projekte qe lidhen me mesimdhenien
1	Sigurimi i një mjedisi mësuesor tërheqës profesional dhe social për të gjitha nivelet	Përfshirja e studentëve në projekte/trainime/kërkime ku vetë pedagogët janë udhëheqës shkencor	Departamenti i Gjeografisë	Konferencë studentore "Gjeografia sot"	20 22 - 20 23	
2	Sigurimi i mësuesorëve të bazuar në kërkim shkencor sidomos për programet e ciklit të dytë	22-25 mars, në kuadër të projektit "Katastrofat nuk njohin kufinj 2", studentet e Masterit Shkencor te Gjeografise ishin pjese e trajnimit ndërkuftar "Parashikimet e motit dhe sistemet e hershme të paralajmërimit", në qytetin e Podgoricës, Mal i Zi. - Me 11-13 tetor 2023, studentet e Masterit Shkencor te Gjeografise ishin pjese e trajnimit, "Parashikimet e motit dhe sistemet e hershme të paralajmërimit", në qytetin e Shkodrës, i organizuar nga Prefektura e Shkodrës në bashkëpunim me Forse Montenegro, një projekt i financuar nga BE				
3	Sigurimi i arsimit të përshtatshëm për tregun e punës dhe që ofron rritjen e kapaciteteve në fushën e zgjidhjes së problemeve	Diversifikimi i kurrikulës me lëndë të reja, jashtë profilit të gjeografisë, por të domosdoshme për plotësimin e portofolit të njohurive sikurse "Menaxhim dhe shkrim	Departamenti i Gjeografisë		20 22 - 20 23	




	<p>projektesh”, “Shprehi dhe teknika komunikimi”  - 5-7 janar 2023 ekspeditë mësimore në terren, pjesa juglindore e Shqipërisë me studentët e masterit Shkencor Gjeografi. Kjo ekspeditë kishte për qëllim njohjen më të mirë të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të kësaj zone, si dhe plotësimin e disa pyetësorëve në lidhje me gjendjen social-ekonomike të zonës dhe proceset e zhvillimit të agroturizmit. 9 qershor 2023 studentët e Gjeografisë ishin pjesë e trajnimit "Menaxhimi i mbetjeve dhe i burimeve ujore".Përgjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit u njohën me kuadrin ligjor dhe rregullator në sektorin e menaxhimit të mbetjeve dhe burimeve ujore, institucionet përgjegjëse, dokumentet strategjike, problematikat, nevojat, planifikimin, rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm në nivel lokal, kombëtar e rajonal mbi menaxhimin e mbetjeve dhe ujit.</p>				
4	<p>Diversifikimi i metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit që inkurajojnë rezultatet e të nxënit dhe i përshtaten shkallëve të ndryshme të njohurive</p>	<p>Përfshirja në programet (syllabuset) e lëndëve e vlerësimit nëpërmjet realizimit të detyrave të kursit në trajtën e projekteve të vogla kërkimore shkencore.</p>	<p>Departamenti i Gjeografisë</p>	<p>20 22 - 20 23</p>	
5	<p>Hapja e programeve (Bachelor ose Master) që targetojnë segmente specifike të tregut të punës</p>	<p>nuk ka patur</p>	<p>Departamenti i Gjeo</p>		



			grafis ë			
6	Ruajtja dhe zhvillimi i lëndëve tradicionale që ofrohen nga programet si elementë të rëndësishëm të formimit bazik në disiplinë.	Ruajtja e ngarkesës së lëndëve tradicionale të gjeografisë fizike dhe humane si lëndë bazë tradicionale të programeve të të gjitha cikleve	Departamenti i Gjeografisë		20 22 - 20 23	
7	Hartimi i leksioneve të reja për programin e ri të studimit Bachelor në "Histori dhe trashëgimi kulturore"	Takime në departament për diskutim rreth leksioneve të reja	Departamenti i Historisë	Realizuar	20 22 - 20 23	
8	Rishikimi i leksioneve ekzistuese për programet e studimit që mbulon departamenti	Takime në departament për diskutim rreth leksioneve të reja për përditesimin e literaturës që i jepet për studim studenteve	Departamenti i Historisë	Realizuar	20 22 - 20 23	Mangesi në Bibliotekën e USH me tituj të rinj
9	Digjitalizimi i procesit mesimor	Realizimi i temave nëpërmjet teknologjive	Departamenti i Historisë	Realizuar	20 22 - 20 23	Mangesi në teknike dixhitale
10	Futja e metodave të reja në procesin e mesimdhënies	Takime në grup lëndesh	Departamenti i Historisë	Realizuar	20 22 - 20 23	Mos përfshirja e stafit të departamentit në projekte që lidhen me mesimdhënien

**FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS**

1	Hapja e programit bachelor në Shkencat e Ushqimit	Diskutimi në departament dhe aplikimi	Departamenti i Biologji-Kimi	U realizua hapja e programit	20 23	
2	Hapja e programit profesional 2 vjeçar "Specialist I lartë elektrik"	Aplikimi	Departamenti I Fizikës	U realizua hapja e programit	20 22	
3	Përmirësimi I infrastrukturës	Krijim dhe përmirësim I laboratoreve	Departamenti I	U realizua hapja e klinikes së	20 23	Janë në process hapjeje edhe



			Lendëve Paraklinike	Fizioterapisë		3 laboratore të tjerë në FSHN
3	Zbatimi I metodave bashkëkohore të mesimdhënis	Aplikimi në projektet e mesimdhënis	FSH N/Departamenti Biologji-Kimi	Pjesëmarrja në projektin Valex	20 20 - 23	
			FSH N/Departamenti Lendëve Klinike	Teaching exchange ëithin the frameëork of the Erasmus+		
4	Perditesimi I syllabuse të lendeve	Rishikimi I literatures	Departamenti e FSH N	U realizua pjesërisht	20 23	
5	Shtimi I stafit akademik me kohe të plote	Kontrolli I rekrutimit të stafit	FSH N/Departamenti Lendëve Paraklinike dhe departamenti matematike	U realizua shtimi I stafit me pedagoge të brendshëm	20 22	
6	Akreditimi I programeve bachelor në Biologji-Kimi, Matematike dhe informatike	Mbikëqyrja e përgatitjeve të dosjeve të aplikimit	FSH N	Pritet përgjigja finale	20 23	
7	Sigurimi I mjediseve të	Ndërhyrjet në ambientet në	FSH	Riparime të	20	



	përshtatshme pune dhe kushteve optimale për stafin akademik	nevojë	N	godinës së FSHN	23	
8	Rritja e bashkëpunimit pedagog- student përmes përfshirjes së tyre në aktivitete shkencore	Konferenca studentore	FSH N/De partamenti Biologji-Kimi	U realizua konferenca në ditën botërore të mjedisit	20 23	

**FAKULTETI EKONOMIK**


1	Sigurimi i një mjedisi mësimor tërheqës profesional dhe social për të gjitha nivelet	Aplikimi i leksioneve në seanca dëgjimore dhe përfshirja në prezantime në detyra kursi të përbashkëta me profesionistë të fushës në lëndën Kontabilitet Financiar	Departamenti Financë - Kontabilitet	Gjatë prezantimit të detyrave të kursit të studentëve, përfshihen dhe profesionistë të fushës për konkretizimin e detyrave në lëndën Kontabilitet Financiar	20 22 - 20 23	
2	Sigurimi i mësimdhënies të bazuar në kërkim shkencor sidomos për programet e ciklit të dytë	Aplikimi i botimeve të përbashkëta me studentë të ciklit master shkencor	Departamenti Financë - Kontabilitet	Përfshirja e studentëve me botime në buletin shkencor	20 22 - 20 23	Në bashkëpunim me pedagogët kanë botuar, sipas temave të diplomave në numrin e rradhës në serinë e shkencave ekonomike
3	Sigurimi i arsimit të përshtatshëm për tregun e punës dhe që ofron rritjen e kapaciteteve në fushën e zgjidhjes së problemeve	Përshtatja e kurrikulës me kërkesat e tregut të punës, rishikohen dhe reflektohen në planet mësimore në çdo periudhë të miratimit të planeve	Departamenti Financë - Kontabilitet	Anëtarët e departamentit Financë - Kontabilitet	20 22 - 20 23	



4	Diversifikimi i metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit që inkurajojnë rezultatet e të nxënësve dhe i përshtaten shkallëve të ndryshme të njohurive	Përfshirja në programet (syllabuset) e lëndëve e vlerësimit nëpërmjet realizimit të detyrave të kursit nga ana e studentëve	Departamenti Financë - Kontabiliteti	studentët e të gjitha viteve në të gjitha programet e studimit	20 22 - 20 23	
5	Hapja e programeve (Bachelor ose Master) që targetojnë segmente specifike të tregut të punës	nuk ka patur	Departamenti Financë - Kontabiliteti			
6	Ruajtja dhe zhvillimi i lëndëve tradicionale që ofrohen nga programet si elementë të rëndësishëm të formimit bazik në disiplinë.	Ruajtja e ngarkesës së lëndëve tradicionale të financës dhe kontabilitetit si lëndë bazë të programeve të të gjitha cikleve	Departamenti Financë - Kontabiliteti		20 22 - 20 23	
7	Rishikimi i leksioneve ekzistuese për programet e studimit që mbulon departamenti	Takime në departament për diskutim rreth leksioneve të reja për përditesimin e literaturës që i jepet për studim studentëve. Lëndet e kontabilitetit nuk kanë ndryshime të mëdha ndër vite, kjo vjen dhe nga specifikat e lëndëve sepse bazohen në standartet, ligjet dhe rregulloret e vendit	Departamenti Financë - Kontabiliteti	Realizuar	20 22 - 20 23	Mangësi në Bibliotekën e USH me tituj të rinj, evidentuar dhe gjatë procesit të akreditimit
8	Digjitalizimi i procesit mesimor	Realizimi i temave nëpërmjet teknologjive	Departamenti Financë - Kontabiliteti	Realizuar	20 22 - 20 23	Mangësi në pajisje fizike elektronike
9	Futja e metodave të reja në procesin e mësimdhënies	Debate në grup lëndesh të financës ose të kontabilitetit, me qëllim që	Departamenti	Realizuar	20 22 -	Mos përfshirja e stafit të departamentit



		te mos kete perseritje te temave nga njera lende tek tjetra apo nga bachelor ne nivel maste	Financë - Kontabilitet		2023	ne projekte qe lidhen me specifikat e mesimdhënies sipas specialiteteve te pedagoqeve
10	Sigurimi i një mjedisi mësues tërheqës profesional dhe social për të gjitha nivelet	Përfshirja e studentëve në projekte/trainime/kërkime ku vetë pedagogët janë udhëheqës shkencor	Departamenti Administrim Biznesi	Konferenca Studentore	Dhjetor 2023	
11	Sigurimi i mesimdhënies të bazuar në kërkim shkencor	2-8 Maj 2023, Salla e Trajnimit të Vazhduar, Kati 0 – Godina Fakulteti Ekonomik, USH, Shkoder. Dy dite trajnime intensive me qëllim informimin dhe përgatitjen e studenteve që kanë aplikuar në njoftimit të publikuar në uebsite të universitetit: Thirrja trajnimit për startup link Thirrja trajnimit për startup (unishk.edu.al). Takimi u organizua nga pedagogu Dr. Mario Çurçija i cili informoi dhe trajnoi pjesëmarrësit që në kuadrin e projektit SUCCESS në Sarajevë, në datat 22-25 Maj 2023 do të zhvillohet një konkurs ndërkombëtar me propozimet me të mira për ide startup të organizuar nga Universiteti Burch, Sarajevë, BiH. Janë trajnuar dhe përgatitur grupe studentesh (Gr. 1 - Antea Bega, Denisa Bajraktari, Gr. 2 - Loreta Çermeli, Elsa Gjeta, Gr. 3 - Dea Tole, Egesa Molla).	Departamenti Administrim Biznesi	Realizuar	2022-2023	



		Ne perfundim juria perzgjodhi per pjesmarrje ne konkursin nderkombetar dy grupe, Gr. 2 dhe Gr. 3.				
1 2	Sigurimi i arsimit të përshtatshëm për tregun e punës dhe që ofron rritjen e kapaciteteve në fushën e zgjidhjes së problemeve	Realizimi i praktikave profesionale që ndihmojnë studentet të lidhin teorinë me praktikën. Vizita në biznese realizur në biznese të ndryshme në kudin e temave me karakter kreative.	Departamenti Administrim Biznes	Realizuar	20 22 - 20 23	
1 3	Diversifikimi i metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit që inkurajojnë rezultatet e të nxëniet dhe i përshtaten shkallëve të ndryshme të njohurive	Përfshirja në programet (syllabuset) e lëndëve e vlerësimit nëpërmjet realizimit të detyrave të kursit, të projekteve, të eseve, testeve, rasteve studimore, prezantimeve etj.	Departamenti Administrim Biznes	Realizuar	20 22 - 20 23	
1 4	Hapja e programeve (Bachelor ose Master) që targetojnë segmente specifike të tregut të punës	nuk ka patur	Departamenti Administrim Biznes			
1 5	Ruajtja dhe zhvillimi i lëndëve tradicionale që ofrohen nga programet si elementë të rëndësishëm të formimit bazik në disiplinë.	Ruajtja e ngarkesës së lëndëve bazë, esenciale të menaxhimit.	Departamenti Administrim Biznes	Realizuar	20 22 - 20 23	
1 6	Rishikimi i leksioneve ekzistuese për programet e studimit që mbulon departamenti	Takime në departament për diskutim rreth leksioneve të reja	Departamenti Administrim Biznes	Realizuar	20 22 - 20 23	
1 7	Digjitalizimi i procesit mesimor	Realizimi i temave nëpërmjet teknologjise,	Departamenti	Realizuar	20 22	



	perdorimi I slidesve ne prezantime, I Mtaems per detyra, komunikim etj.	nti Admi nistri m Bizne s		- 20 23	
1 8	Futja e metodave te reja ne procesin e mesimdhënies	Në përmirësim të vazhdueshem	Depa rtame nti Admi nistri m Bizne s	Realizuar	20 22 - 20 23
1 9	Sigurimi i një mjedisi mësimor tërheqës profesional dhe social për të gjitha nivelet	A) Perdorimi i infrastruktures, IT dhe organizimi i ambienteve mesimor bashkohoree te FE ne sherbim te krijimit te mjedisi diskutimesh interaktive dhe mundesi per te gjithë holumtimesh on-line per informacione te publikuara ne sherbim te zhvillimit te deturave te kursit. B) Trajnim i stafit akademik me metodat bashkekohoret te mesimdhënies me qender studentin, pjesmarrja e stafit akademik ne mobilitete ne universitete te huaja, ne konferenca, ëorkshope per te kontribuar ne kualifikim te metejshem profesional dhe shkencor te stafit akademik qe reflektohet ne mesimdhënie C) Zhvillimi i leksioneve, seminareve te hapura nga pedagog te ftuar nga universitetet e huaja D) Te ftuarit te eksperteve te turizmit ne auditor per	FE/D epart amen ti I Turiz mit	Realizuar	20 22 - 20 23



		tema specifike aktuale te zhvillimeve te turizmit, politikave turistike, bizneseve turistike.				
20	Sigurimi i mësimdhënies të bazuar në kërkim shkencor sidomos për programet e ciklit të dytë	A) Aplikimi i botimeve të përbashkëta pedagog me studentë të ciklit master B) Pjesmarrja e studenteve ne konferencen studentore 'Sfidat e zhvillimit Rajonal'	FE/D epart amen ti I Turiz mit	Realizuar	20 22 - 20 23	
21	Sigurimi i arsimit të përshtatshëm për tregun e punës dhe që ofron rritjen e kapaciteteve në fushën e zgjidhjes së problemeve	A)Përshtatja e kurrikulës me kërkesat e tregut të punës dhe kërkesen e pergaditjes se kapaciteve njerzore te zgjidhjes se sfidave te zhvillimit te turizmit ne menyre te qendrueshme behet duke rishikuar dhe reflektuar në planet mësimore në çdo periudhë të miratimit të planeve Informacioni i strukturuar që arrihet të merret nga anketimi i të diplomuarve të punësuar dhe i bizneseve turistike subjekteve publike me pyetsoret e miratuar për të thith opinione mbi kërkesat e tregut të punës kontribon në përshtatjen e programeve të studimit qe ofron Departamenti i Turizmit me njohuritë dhe aftësitë që tregu i punes kërkon. B) Zhvillimi i praktikës profesionale ne subjekte publike dhe private me marreveshje institucionale	Depa rtame nti I Turiz mit	Realizuar	20 22 - 20 23	
22	Diversifikimi i metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit që inkurajojnë rezultatet e të nxëniet dhe i përshtaten shkallëve të ndryshme të njohurive	Per realizimin e lëndëve eshte punuar drejt dy kompetencace kryesore: teorike dhe praktike. Në aspektin teorik studentët përfitojnë nga prezantimet	Depa rtame nti I Turiz mit	Realizuar	20 22 - 20 23	

e leksioneve në ppt, literatura e rekomanduar. Ndërsa në aspektin praktik janë realizuar nën drejtimin e pedagogut të lëndës gjatë orës së mësimit diskutime në grupe ku studentët paraqesin idete e tyre lidhur me temën që trajtohet dhe interpretimin e tyre mbi njohuritë e marra por edhe janë zhvilluar ekskursionet mesimore pranë bizneseve, apo janë ftuar ekspert/ menaxher të sukseshëm të turizmit për të prezantuar eksperiencën e suksesi, si dhe prezantimin e detyrave të kursit në grup, prezantim dhe diskutim rastesh studimore etj. Per konkretizim e koncepteve teorike të lëndës kanë shërbyer edhe aktivitetet e bera me studentet nën drejtimin e pedagogut të lëndës ku angazhimi i studentëve i konvertohet në pikë detyrë kurse, si: - Aktiviteti Panairi i përvitshëm 'Do great things' me studentët e vitit të parë të turizmit, - Aktiviteti 'ËOË Albania' 2023 i studentave të turizmit me studentët e turizmit të dy universiteteve belge HOGENT dhe HOËEST për krijim konceptesh inovative turistike për Rajonin e Shkodrës', Aktiviteti për markim shtigjesh për në Kalanë e Danjës dhe





		digjitalizim në hartë, etj				
2 3	Hapja e programeve të reja që targetojnë segmente specifike të tregut të punës	A) Hapja e programit të ciklit të tretë të studimeve Doktoratë në 'Ekonomi dhe Turizëm i qëndrueshëm, B) Përgatitja e dosjes për aplikim me 30 Nëntor të 2023 për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimit Master shkencor në 'Marketing inovativ' duke zhvilluar studim tregu në nivel makro dhe micro për marketier inovativ dhe botimi i tyre në buletin shkencor të USH, seria e shkencave ekonomike.	Departamenti i Turizmit	Realizuar	20 22 - 20 23	
2 4	Ruajtja dhe zhvillimi i lëndëve tradicionale që ofrohen nga programet si elementë të rëndësishëm të formimit bazik në disiplinë.	Ruajtja e ngarkesës mesimore të lendeve baze dhe karakterizuese të programit të studimit dhe zhvillimi i tyre duke nderthuar	Departamenti i Turizmit	Realizuar	20 22 - 20 23	
2 5	Rishikimi i Syllabuseve ekzistuese për programet e studimit që mbulon departamenti	Syllabuset ekzistuese përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në koherencë me nevojat e tregut të punës duke i zhvilluar temat e leksioneve ekzistuese ose duke shtuar tema të reja me literaturë dhe botime bashkëohore të siguruar nga mobilitetet e pedagogëve në universitetet e BE. Këto nevoja të tregut të punës vlerësohen nga takimi me përfaqësuesit e bizneseve në takim post-Paniri i punës, nga feedback-u i mbikqyesve të subjekteve të praktikës për studentet që kanë kryer praktiken në këto subjekte, nga studimi i	Departamenti I Turizmit	Realizuar	20 22 - 20 23	Nevojë për blerjen e 85 librave bashkëkohore të kerkuara tesh dy vite nga Departamenti I turizmit dhe të miratuara në buxhetet vjetore të USH por pa u bërë realitet blerja e tyre



		tregut te punes per aftesi, kompetence e dije, njohuri te reja qe kerkojne nga studentet menaxher te ardhshem te turizmit				
26	Digjitalizimi i procesit mesimor	Realizimi i prezantimit te leksioneve duke integruar teknologjine, perdorimi i Mtaems komunikim, dergim literature, prezantimi, detyra kursi, per sqarime ne lidhje me mesimin dhe detyrat e kursit, pergaditja dhe mbrotja e temes se diplomes nga studentet. etj.	Departamenti I Turizmit	Realizuar	20 22 - 20 23	
27	Futja e metodave te reja ne procesin e mesimdhënies	Trajnime te personelit akademik per futjen e metodave te bashkepunuese me ne qender studentin. Ëorkshop online me disa faza rreth metodave të reja të mësimdhënies dhe diskutimeve bashkëpunues nga Interactivity Foundation (Washington DC. USA)	USH/FE/Departamenti I Turizmit	Ne vazhdim	M e 27 Pr ill 20 23 e ne va zh di m	
28	Realizim orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë, strategjish inovative per zhvillimin e turizmit te qendrueshem.	Leksion i hapur 'Teoria bashkëkohore e kulturës - Ide moderne dhe trende dixhitale', Ëidzeme University, Latvia 16.Mars.2023 Leksion i hapur "Turizmi muzikorë dhe holistik dhe Shkoder' UNISHK 13 Prill 2023 Leksion i hapur 'Ngjarja si mjet promorcional i destinacionit dhe pjese e eksperiences se vizitorve'. Ëidzeme University, Latvia 8 Maj 2023	Departamenti I Turizmit	Realizuar	20 22 - 20 23	



		Leksion i hapur 'Hotelet e shperndara ne zonat malore dhe rurale' Komuna Sauris, Itali.07Qeshor 2023 Pjesmarrja e pedagoqeve dhe studenteve ne keto evente akademike reflektohet direkt ne cilesine e programeve studimore				
<b>FAKULTETI I DREJTËSISË</b>						
<b>I</b>	<b>Diplomë e integruar"Master i Shkencave në Drejtësi</b>		Fakulteti i Drejtësisë	100%	20 22 - 20 23	
<b>1</b>	Formimi i studentëve me njohuri të thelluara në fushat e ndryshme të së drejtës.	Përdorimi i literaturës bashkëkohore dhe jurisprudencës së GJL, GJK dhe vendimarrjes së institucioneve të ndryshme				
<b>2</b>	Aftësimin e studentëve për të vlerësuar dhe për të trajtuar çështje me karakter juridik, përmes nxitjes dhe zhvillimit të mendimit kritik.	Trajtimi shkencor dhe nxitja e debatit dhe diskutimit lidhur me çështje aktuale në fushën e së drejtës				
<b>3</b>	Aftësimin e studentëve për të analizuar dhe interpretuar lidhur me zgjidhjen e përshtatshme të çështjeve juridike të përgjithshme dhe të veçanta	Trajtimi i çështjeve konkrete në fushën e së drejtës dhe zgjidhjeve të mundshme				
<b>4</b>	Thellimin e aftësisë për të punuar në grup duke, nxitur një shkallë të lartë autonomie dhe përgjegjësie, personale dhe profesionale, në koordinim edhe me operatorët e tjerë profesionalë ndërveprues.	Realizimi i punëve në grup, detyrave të kursit, pjesëmarrja në projekte e konkurse në fushën e së drejtës.				
<b>5</b>	Përbushja e nivelit të	Plani mësimor dhe				



	arsimimit që kërkohet për vazhdimin e studimit apo ushtrimin e profesioneve të ndryshme: si shkolla e magjistraturës, shkolla e avokatisë, trajnimit për tu pajisur me licencën e noterit, ndërmjetesit apo përmbaruesit gjyqësor.	programet e lëndëve janë në përputhje me kërkesat për vazhdim të mëtejshëm të arsimit dhe kualifikimit				
<b>I I</b>	<b>Master shkencor 'E drejtë kushtetuese dhe administrative'</b>		Fakulteti i Drejtësisë	100%	20 22 - 20 23	
<b>1</b>	Formimi i studentëve me njohuri të thelluara në fushën e së drejtës kushtetuese dhe administrative dhe fusha të lidhura me to.	Përdorimi i literaturës bashkëkohore dhe jurisprudencës së GJL, GJK dhe vendimarrjes së institucioneve të ndryshme				
<b>2</b>	Aftësimin e studentëve për të vlerësuar dhe për të trajtuar çështje me karakter kushtetues dhe administrativ, përmes nxitjes dhe zhvillimit të mendimit kritik.	Trajtimi shkencor dhe nxitja e debatit dhe diskutimit lidhur me çështje aktuale në fushën e së drejtës				
<b>3</b>	Aftësimin e studentëve për të analizuar dhe interpretuar lidhur me zgjidhjen e përshtatshme të çështjeve kushtetues dhe administrativ	Trajtimi i çështjeve konkrete në fushën e së drejtës dhe zgjidhjeve të mundshme				
<b>4</b>	Thellimin e aftësisë për të punuar në grup duke, nxitur një shkallë të lartë autonomie dhe përgjegjësie, personale dhe profesionale, në koordinim edhe me operatorët e tjerë profesionalë ndërveprues.	Realizimi i punëve në grup, detyrave të kursit, pjesëmarrja në projekte e konkurse në fushën e së drejtës.				
<b>5</b>	Përmbushja e nivelit të arsimit që kërkohet për vazhdimin e studimit apo ushtrimin e profesioneve	Plani mësimor dhe programet e lëndëve janë në përputhje me kërkesat për vazhdim të mëtejshëm				

	të ndryshme: si shkolla e magjistraturës, shkolla e avokatisë, trajnimit për tu pajisur me licencën e noterit, ndërmjetesit apo përmbartuesit gjyqësor.	të arsimimit dhe kualifikimit				
<b>I</b>	<b>Master shkencor 'E drejtë kushtetuese civile'</b>		Fakulteti i Drejtësisë	100%	20 22 - 20 23	
<b>1</b>	Formimi i studentëve me njohuri të thelluara në disiplinat juridike.	Përdorimi i literaturës bashkëkohore dhe jurisprudencës së GJL, GJK dhe vendimarrjes së institucioneve të ndryshme				
<b>2</b>	Aftësimin e studentëve për të vlerësuar dhe për të trajtuar çështje me karakter juridik në kuadrin e veprimtarisë dhe funksionimit të subjekteve private dhe të sipërmarrjes tregtare, si dhe në ushtrimin e profesioneve të lira	Trajtimi shkencor dhe nxitja e debatit dhe diskutimit lidhur me çështje aktuale në fushën e së drejtës				
<b>3</b>	Aftësimin e studentëve për të analizuar dhe interpretuar lidhur me zgjidhjen e përshtatshme të çështjeve juridike të përgjithshme dhe të veçanta.	Trajtimi i çështjeve konkrete në fushën e së drejtës dhe zgjidhjeve të mundshme				
<b>4</b>	Thellimin e aftësisë për të punuar në grup duke, nxitur një shkallë të lartë autonomie dhe përgjegjësie, personale dhe profesionale, në koordinim edhe me operatorët e tjerë profesionalë ndërveprues.	Realizimi i punëve në grup, detyrave të kursit, pjesëmarrja në projekte e konkurse në fushën e së drejtës.				
<b>5</b>	Arritjen e aftësisë për të marrë vendime sipërmarrëse në përshtatje me vlerësimin dhe	Plani mësimor dhe programet e lëndëve janë në përputhje me kërkesat për vazhdim të mëtejshëm				



	trajtimin e të dhënave ekonomike dhe shoqerore në përputhje me studimet sektoriale dhe territoriale, duke koordinuar metodat e shkencave ekonomike dhe juridike.	të arsimimit dhe kualifikimit				
<b>I</b> <b>V</b>	<b>Bachelor në Drejtësi</b>		Fakulteti i Drejtësisë	100%	20 22 - 20 23	Nga viti 2022-2023 nuk është më aktiv, pasi ka ndryshuar sistemi prog në edukimin ligjor
<b>1</b>	Formimi i studentëve me njohuri të përgjithshme në disipinat juridike.	Përdorimi i literaturës bashkëkohore dhe jurisprudencës së GJL, GJK dhe vendimarrjes së institucioneve të ndryshme				
<b>2</b>	Aftësimin e studentëve për të vlerësuar dhe për të trajtuar çështje me karakter juridik, në kuadrin e veprimtarisë dhe funksionimit të organeve të administratës publike, subjekteve private dhe të sipërmarrjes tregtare, si dhe në ushtrimin e profesioneve të lira	Trajtimi shkencor dhe nxitja e debatit dhe diskutimit lidhur me çështje aktuale në fushën e së drejtës				
<b>3</b>	Aftësimin e studentëve për të analizuar dhe interpretuar lidhur me zgjidhjen e përshtatshme të çështjeve juridike të përgjithshme dhe të veçanta.	Trajtimi i çështjeve konkrete në fushën e së drejtës dhe zgjidhjeve të mundshme				

**ii.Fusha Kërkimi Shkencor dhe Veprimtaria Krijuese dhe Inovacioni**

**a-Qëllimet dhe objektivat e kërkimit shkencor**

Universiteti i Shkodrës është i vetmi institucion publik i Arsimit të Lartë në Veriun e Shqipërisë. Aktivitetet kërkimore në USH bazohen në lirinë e kërkimit, lirinë akademike, profesionalizmin, integritetin akademik e personal dhe ndershmërinë e kërkimit.

Përfshirje e studenteve në kërkimin shkencor, hapja e programeve të reja si dhe hapja e programit të tretë të studimit në Turizëm të qëndrueshëm dhe në Gjuhën shqipe plotëson kuadrin e formimit të plotë të kërkuesve shkencore në këto fusha të rëndësishme.

Dy qendra të kërkimit shkencor Qendra e Studimit të Ujrave në Rajonin e Shkodrës, si dhe Qendra e Studimeve Albanologjike punojnë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe në atë Shkencave Shoqërore në mënyrë të vazhdueshme me fokus kërkimin në fushat respektive, botimet dhe konferencat shkencore.

Institucioni ndjek një politikë të qartë për hartimin dhe zbatimin e projekteve kërkimore në bashkëpunim me organizma të tjerë shkencorë. Çdo studiues që është nënshkruar në një aplikim për financim, qoftë i financuar nga USH apo fonde jashtë USH-së, përpiqet të sigurojë se informacioni i paraqitur është i qartë e i saktë dhe mbahet përgjegjës për çdo plagjiaturë. Kërkuesi shkencor, drejtuesi i një projekti kërkimor etj., synon të tregojë gatishmëri për monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarisë së tij kërkimore që drejton apo në të cilën merr pjesë.

Stafet janë lidhja mes vizioneve dhe veprimtarive ditore të institucionit.

Në një proces gjithëpërfshirës, filozofia që ndiqet është t'i jepet stafit ndihmesë dhe, kur është e përshtatshme, kompetencë kur përcaktohen burimet dhe mjetet e programit dhe të institucionit. Këta individë janë mbështetur për botimet, pjesëmarrjen në konferenca, botimet financiarisht ana e Universitetit tonë.

USH përpiqet që të ndërtojë dite pas dite themele për marrëdhënie të ardhshme në punën shkencore dhe shoqëri përmes shërbimeve komunitare. Plotësimi i H4 dhe lidhja me autoritetet publike, organizata të shoqërisë civile, mediat si dhe biznesin janë një synim i vazhdueshëm i punës mësimore, kërkimore shkencore në USH.

**Tabela nr. 2: Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit**

Objektivi I: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit						
Nr	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Fakulteti/Drejtor ia/Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1	Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor	Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare dhe botimi i punimeve në revista prestigjioze	F. i Drejtësi së	100%	20	
		Hartimin i projekteve në fushën e së drejtës			-	
		Pjesëmarrja në projekte ku USH është lider apo partner			20	
		Pjesëmarrja në rrjete ekspertësh ligjorë			23	

		Realizimi i botimeve duke u bazuar në përdorimin e literaturës bashkëkohore në fushën e së drejtës				Do të ishte pozitive aboni mi në revist a juridi ke online
2	Përsosmëria në kërkim e lidhja me tregun e punës	FD ka lidhje me institucionet e drejtësisë, administratën publike dhe subjekte të tjera në fushën e së drejtës Projektet e detyrat e kursit adresojnë problematikat kryesore në fushën e së drejtës. Programet e lëndëve përditësohen në mënyrë që të nxisin kërkimin shkencor, duket e lidhur dhe me kërkesat e tregut të punës	F. i Drejtësi së	100%	20 22 - 20 23	
3	Plani i barazisë gjinore në kërkimin shkencor	Punime të ndryshme nga pedagogë e studentë adresojnë barazinë gjinore. Anëtarë të stafit janë pjesë e projekteve e rrjeteve të ekspertëve në fushën e BGJ	F. i Drejtësi së	100%	20 22 - 20 23	
4	Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor	Studentë mbarojnë studimet master përmes paraqitjes së një punimi të drejtuar nga stafi akademik Studentët përfshihen në projekte të hartuara e zbatuara nga stafi akademik I FD Studentët marrin pjesë në konkurse kombëtare e ndërkombëtare në fushën e së drejtës	F. i Drejtësi së	100%	20 22 - 20 23	
5	Ndërko mbëtarizimi	Stafi akademik dhe studentët janë përfitues të programeve të shkëmbimit ERASMUS	F. i Drejtësi së	100%	20 22 - 20 23	
6	Rritja e veprimtarisë së kërkimit shkencor në fushën e gjuhësisë, letërsisë, përkthimit, komunikimit ndërkulturore dhe gjuhës	Kontakt i vazhdueshëm me literaturën bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare.	F. i Gjuhëve të Huaja	100%	20 22 - 20 23	

	sektorial e;					
7	Paraqitja veprimtarisë së kërkimit shkencor jo vetëm në mjediset akademike, por edhe për publikun e gjerë duke arritur deri në publikun e sistemit parauniversitar;	Realizim orësh të hapura	F. i Gjuhëve të Huaja	100%	20 22 - 20 23	
8	Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, jo vetëm mes aktiviteteve të ndryshme shkencore, por edhe punimeve individuale të studentëve të drejtuar nga pedagogët;	Përgatitje e studentëve me aftësi biznesi turistik dhe kulturor	F. i Gjuhëve të Huaja	100%	20 22 - 20 23	
9	përditësimi i metodave	Kontakt i vazhdueshëm me literaturën bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare.	F. i Gjuhëve të Huaja	100%	20 22 -	

	e të reja kërkimore;				20 23	
10	përfshirja e studentëve dhe pedagogëve në projektet ndërkombe tëare.	hartim projektesh me universitetet partnere	F. i Gjuhëve të Huaja	100%	20 22 - 20 23	
11	Nxitijs së vazhdueshme të kualifikimit shkencor të stafit akademik.	Përgatitje dhe mbrojtje c titujve akademikë , Trajnime profesionale , Regjistrime shkolla doktrale	F. i Gjuhëve të Huaja	100%	20 22 - 20 23	
12	Përditësi mit të njohurive dhe metodave të reja kërkimore me synim rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor	Trajnime dhe hulumtime individuale dhe të organizuara nga institucione të ndryshme	F. i Gjuhëve të Huaja	100%	20 22 - 20 23	
13	Nxitijs e studentëve për të marrë pjesë në projekte kombëtare apo ndërkombe tëare	Angazhimi i studentëve në projekte me qëllim hulumtime dhe kërkime në bibliotekë, online dhe në terren	F. i Gjuhëve të Huaja	100%	20 22 - 20 23	
14	Përfshirjen e studentëve në aktivitete të ndryshme	Udhëheqjet nga stafi akademik në nivel lënde apo në përmblylje të ciklit të studimit qoftë Bachelor qoftë Master Profesional	F. i Gjuhëve të Huaja	100%	20 22 - 20 23	




	shkencor e si me punime individuale, ashtu edhe me punime në grup të udhëhequra nga pedagogu përkatës.					
15	Vazhdimin e shkëmbimit të studentëve me Universitetin e Vechta-s, Gjermani nëpërmjet programit Erasmus .	Asistimi në ndo faze të këtij procesi, që nga aplikimi i studentëve e deri në njohje të lëndëve të shlyera pranë Universitetit pritës të Vechta-s.	F. i Gjuhëve të Huaja	100%	20 22 - 20 23	
16	Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor .	Realizimi i artikujve shkencorë të botuar në revista shkencore kombëtare, ndërkombëtare; pjesëmarrja në konferenca shkencore kombëtare, konferenca ndërkombëtare, konferenca të tjera, simpoziume, forume etj.	F. i Shkencave të Edukimit	Po	20 22 - 20 23	Në departamentin e Psikologjisë e Punës Sociale, numri i artikujve të botuar brenda vendit është 4 (katër),

					<p>numri 1 konfer encav e, konfer ess brend a vendit (kumt esa të botuar a) është 13 (trem bëdhj etë), numri i Konfe renca ve, kongr cse vende OEC D/G2 0 (kumt esa të botuar a) është 5 (pesë) . Në depart ament in e Mësu esisë, numri i artikuj ve të botuar brend a vendit është 3 (tre), numri</p>
--	--	--	--	--	---





						 esatë botuar është 7 (shtatë).
17	pjesëmarrja në projekte kërkimore	2 (dy) projekte shkencore brenda vendit dhe 3 (tre) jashtë vendit.	F. i Shkenca ve të Edukimit	Po	20 22 - 20 23	
